



Në bazë të nenit 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja r) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), dhe në zbatim të Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe Pjesëmarrje të Rinisë neni 14 dhe në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.10/2010 për punën vullnetare të të rinjve, Kuvendi Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2016, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit

Neni 1

1. Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit, i marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe subjektit juridik organizator të vullnetarizmit, për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në komunë.

Neni 2

Fusha e Zbatimit

1. Kjo rregullore, rregullon punën vullnetare të të rinjve në komunë, ku puna vullnetare, principet dhe termat rregullohen si të drejta dhe obligime të vullnetarëve dhe të subjekteve organizatore të vullnetarizmit. Rregullon kushtet për përpilimin dhe zbatimin e kontratave të vullnetarizmit, kodit etik, lëshimin e certifikatave për vullnetarët, vlerësimin me çmime e benificione për punën vullnetare dhe garantimin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Kjo rregullore trajton të gjitha llojet e marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe subjekteve organizatore të vullnetarizmit, gjatë kryerjes së aktiviteteve jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.

3. Kjo rregullore aplikohet tek shërbimet dhe aktivitetet komunale, realizimi i të cilave organizohet në mënyrat që përcakton kjo rregullore.

Neni 3

Përkufizime:

1. Në këtë rregullore përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1. **Vullnetar** – siç është përcaktuar edhe në ligj dhe udhëzim administrativ, është individi i cili investon kohë, përpjekje, njohuri apo aftësi vetjake me vullnetin e tij të lirë, në shërbim të aktiviteteve dhe veprimtarive të kryera me qëllim mirëqenien e një individi tjetër apo të publikut të gjerë. Personi apo grupi i personave që zhvillojnë aktivitet vullnetar pa kërkuar në shkëmbim asnjë formë shpërblimi financiar apo material për angazhimin e tij/tyre. Një vullnetar është individi që zotëron aftësi për punë dhe është vullnetar në komunën e Rahovecit.

- 1.2. **Vullnetar minoren**, është një vullnetar i ri nën moshën 16 vjeç, i cili kryen punë vullnetare në komunë.
- 1.3. **Kontratë vullnetarizmi** – Kontratë e lidhur me vullnet të lirë, midis subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, për zhvillimin e aktiviteteve apo veprimtarive jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.
- 1.4. **Mentor** – është individi lider i cili bën mbikëqyrjen e punës dhe këshillimin e vullnetarit apo grupit të vullnetarëve.
- 1.5. Përveç përkufizimeve të përcaktuara me këtë rregullore do të shërbejnë edhe përkufizimet e përcaktuara në udhëzimin administrativ për punën vullnetare të të rinjve.

Neni 4

Përfitimet e komunës nga puna vullnetare

1. Nxitja e qytetarisë aktive;
2. Ndhmon komunën në realizimin e projekteve në interes publik;
3. Promovimin dhe fuqizimin e vlerave të të rinjve në komunë;
4. Përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.
5. Forcon bashkëpunimin dhe besimin në mes qytetarëve dhe Komunës.
6. Ndhmon Komunën në realizimin e interesave të tjera për komunitetin.
7. Ndhmon Komunën në afirmimin e saj në procesin e integritimit;
8. Ndhmon integritimin e të rinjve brenda komuniteteve.

Neni 5

Promovimi

1. Vullnetarizmi njihet dhe promovohet si një aktivitet i një interesi të veçantë për Komunën, për aq sa përmirëson cilësinë e jetës, stimulon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore dhe kontribuon në zhvillimin e një shoqërie të barabartë, humane dhe demokratike.
2. Roli i vullnetarizmit dhe rëndësia e tij duhet të përcillen tek të rinjtë nëpërmjet aktiviteteve jashtë arsimore në shkollimin e ulët dhe të mesëm. Kjo duhet të përcillet me aktivitet praktik duke i angazhuar nxënësit në punë të dobishme shoqërore.

Neni 6

Punët që nuk konsiderohen punë vullnetare

- Referuar kësaj rregulloreje, nuk konsiderohet vullnetarizëm si më poshtë:
- a. Kryerja e aktiviteteve vullnetare ose ofrimi i shërbimeve që nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.
 - b. Zhvillimi i aktiviteteve ose ofrimi i shërbimeve kundrejt përfitimit financiar apo material të parregulluar nga kontrata të rregullta sipas ligjit të Punës
 - c. Kryerja e punëve pa shpërblim, natyra e të cilave i përket një marrëdhënie punësimi që rregullohet me ligjin e Punës
 - d. Kryerjen e punëve ose ofrimi i shërbimeve kur njëra palë është e detyruar të kryejë për palë të treta, siç përcaktohet me ligj apo akte nënligjore

- e. Përmbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e aktiviteteve që një individ është i detyruar t'i zhvillojë për një palë të tretë të përcaktuar me ligj apo rregulloret të tjera
- f. Zbatimit të detyrimeve të veçanta në përputhje me vendim gjykatë,
- g. Kryerja e veprimtarive ose shërbimeve që janë për përfitim të rrethit familjar apo miqësor.

Neni 7

Puna vullnetare në Komunë bëhet për interes publik.

Neni 8

Trajtimi i vullnetarëve

1. Organizatori punës vullnetare në komunë është i detyruar të trajtojë vullnetarët në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, bindjeve politike apo të besimit, përkatësisë nacionale apo sociale, gjendjes financiare, arsimimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësisë familjare, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve etj.
2. Aktivitetet lidhur me punët vullnetare që i zhvillojnë partitë politike nuk trajtohen me këtë rregullore.

Neni 9

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mentorimi

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjës për këto çështje:
 - 1.1. të mbajë regjistrin e vullnetarëve të pranuar nga organizatori i punës vullnetare,
 - 1.2. të përcjellë regjistrat e vullnetarëve në nivel qendror – Departamentit të rinisë në MKRS,
 - 1.3. të pranojë kërkesat nga organizuesit e punës vullnetare për pajisje me librezë vullnetare,
 - 1.4. të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin tjetër përkatës dhe vendosë që të lëshojë nga një librezë për secilin vullnetar të paraqitur,
 - 1.5. të përcjellë ndryshimet eventuale në statusin dhe marrëveshjen e vullnetarit dhe kujdeset që këto ndryshime të jenë në pajtim me këtë rregullore dhe ligj.
 - 1.6. të bëjë verifikimin e të dhënave në librezë pas përfundimit të punës vullnetare, nëse janë të plotësuara në pajtim me udhëzimet ligjore dhe marrëveshjen,
 - 1.7. bën vërtetimin e librezave duke i vulosur,
 - 1.8. kryen edhe punë të tjera që lidhen me aktivitetin e punës vullnetare në Komunë e që nuk bie ndesh me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 10

1. Mentori është përgjegjës për këto çështje:
 - a. bën koordinimin e punëve bashkë me vullnetarin/vullnetarët
 - b. bën përcaktimin e objektivave të aktivitetit për zhvillimin e punës vullnetare;

- c. për monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit/ grupit të vullnetarëve,
- d. bën raport për zhvillimin e punës nga ana e vullnetarit, ku përfshihen orët vullnetare të mbajtura, sfidat gjatë kryerjes së punës vullnetare, trajnimet që janë propozuar në mes vullnetarit dhe mentorit, efektet e arritura që maten nga performanca në punë, aftësitë e veçanta të treguara nga vullnetari,
- d. kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 11

1. Kriteret dhe kushtet që duhet t'i plotësojë mentori i përcakton organizuesi i punës vullnetare.
2. Mentori duhet të ketë vlera morale dhe përvojë relevante.

Neni 12 Obligimet e vullnetarëve

Obligimet e vullnetarëve janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.

Neni 13 Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare

Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare bëhet në pajtim me udhëzimin administrativ.

Neni 14 Kompensimi i dëmit

Kompensimi i dëmit caktohet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

Neni 15 Përfundimi i punës vullnetare

Përfundimi i punës vullnetare bëhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

Neni 16 Motivimi i vullnetarëve

1. Hyrje pa pagesë në ndeshjet sportive në stadiumet në tërë territorin e komunës së Rahovcit, në palestra sportive dhe në të gjitha organizimet sportive të organizuara nga Komuna.
2. Hyrje pa pagesë në shfaqjet teatrale që shfaqen në sallën e qendrës kulturore "Mensur Zyberaj" dhe në të sallat tjera të administruara nga Komuna (kur Komuna është organizatore).
3. Regjistrim pa pagesë në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec dhe në bibilotekat tjera publike të administruara nga Komuna.
4. Konsiderimi i përvojës së punës vullnetare nga ana e organeve dhe institucioneve komunale.

5. Përparësi në përfitimin e bursave;
6. Përparësi në shërbimet publike komunale;
7. Përparësi në pjesëmarrjen në trajnime;
8. Të drejtë për shfrytëzimin e objekteve publike për aktivitetet e organizatave vullnetare;
9. Ndarja e shpërblimeve për punën vullnetare;
10. Promovimi i rezultateve nga puna vullnetare në mjetet publike për publikim (Ueb faqen e Komunës, revista, fletpalosje etj.);
11. Organizimi i aktiviteteve kulturore për vullnetarë;
12. Përfshirja e vullnetarëve në organizimin e aktiviteteve kulturore të organizuar nga Komuna;
13. Mundësi për kryerjen e punës praktike në institucionet publike/administratë komunale;
14. Organizimi i fushatës promovuese të vullnetarizmit.

Neni 17

Integrimi i punës vullnetare brenda planit të veprimit

1. Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjesë e planit të punës, planit të veprimit dhe çdo dokumenti tjetër të drejtorisë përgjegjëse për rini.

Neni 18

Vullnetarizmi brenda KVRL, qendrave rinore dhe grupeve rinore.

Aktivitetet e kryera ose shërbimet e ofruara nga KVRL dhe Qendra rinore që veprojnë brenda komunës parim kryesor do të kenë punën vullnetare, nëpërmjet së cilës bëjnë ngritjen e vetëdijes për punë vullnetare të anëtarëve të saj.

Neni 19

Baza e të dhënave

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport obligohet të mbajë bazën e të dhënave me qëllim të monitorimit të punës vullnetare;

Neni 20

Buxheti

Aktivitetet vullnetare duhet të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore komunale;

Neni 21

Puna vullnetare gjatë procesit mësimor

Aktivitetet e punës vullnetare nuk mund t'i përcjellin nxënësit gjatë procesit mësimor.

Neni 22**Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bën Kryetari i Komunës, kurse zbatimin e saj e bën Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 23

Aspektet e vullnetarizmit të rregulluara me këtë rregullore, si dhe marrëdhëniet që dalin nga kontrata e vullnetarizmit, që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, janë objekt i dispozitave të përgjithshme ligjore.

Neni 24

Në rast konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj rregullore dhe dispozitave të Ligjit Nr 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë në punë vullnetare, të dispozitave të UA Nr. 10/2010 për punë vullnetare të rinisë, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe të udhëzimit administrativ.

Neni 25

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedura të njëjta me ato të miratimit në Kuvendin e Komunës së Rahvecit me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

Neni 26

Pas miratimit në Kuvend kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës të MAPL si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe në Web faqen e komunës.

01 Nr. 2120
Rahovec, 28.06.2016

